

VENDIM
Nr.13, datë 7.1.2010

**PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË DËRGUAR NË BOSNJË-HERCEGOVINË, NË KUADËR TË
OPERACIONIT USHTARAK "ALTHEA" TË BASHKIMIT EUROPIAN**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 198, datë 22.2.2012)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ nr.2, datë 8.4.2008 "Për dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin "ALTHEA" të Bashkimit European", miratuar me ligjin nr.9907, datë 24.4.2008, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimi ditor për ushtarakët shqiptarë të dërguar në Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit "ALTHEA" të Bashkimit European, të jetë 6 000 (gjashtë mijë) lekë, për çdo ditë qëndrimi në këtë mision.

1.1. Kohëzgjatja e misionit të jetë deri në fund të vitit 2013, me rotacion çdo 6 (gjashtë) muaj. Rotacionit i shtohet edhe koha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vendimi nr.477, datë 23.6.2005 i Këshillit të Ministrave "Për shpërblimin e ushtarakëve, pjesëmarrës në operacionin "ALTHEA" të Bashkimit European, në Bosnjë-Hercegovinë", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha